


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Ministri

Tiranë, më 15.08 2013

Nr. 327/Or.
1

URDHËR

Nr. 327 datë 15.08.2013

PËR

**AKREDITIMIN INSTITUCIONAL DHE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT QË
PËRFUNDON MË MASTER PROFESIONAL NË "MENAXHIM INFERMIEROR" TË
AKADEMISË SË STUDIMEVE TË APLIKUARA "REALD", VLORE**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.03.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar:

URDHËROJ:

1. Akreditimin institucional të Akademisë së Studimeve të Aplikuara "Reald", Vlorë, sipas vendimit të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, nr. 512 datë 18.07.2013, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Akreditimin e programit të studimit që përfundon me Master Profesional në "Menaxhim Infermieror", sipas vendimit të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, nr. 512 datë 18.07.2013, bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Akademia e Studimeve të Aplikuara "Reald", Vlorë, brenda 6 muajve nga dalja e këtij urdhri të plotësojë rekomandimet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë nr. 512, datë 18.07.2013, bashkëlidhur.
4. Akademia e Studimeve të Aplikuara "Reald", Vlorë, t'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik institucional dhe të programeve të studimit çdo 6 vjet,

sipas pikës 4, neni 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

5. Urdhri bëhet publik në faqen elektronike zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jo publik dhe Akademia e Studimeve të Aplikuara "Reald", Vlorë.

Ky Urdhër lryn në fuqi menjëherë.

MYQEREM TAJAJ

MINISTER

Më rrugë dhe me porosi

Z. KURBANXHE

Ilir Kurbani

